



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 27 Korrik 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Gani Geci, Agim Veliu, Melihate Termkolli, dhe Zylfi Merxha.

Munguan: Zafir Berisha, Bojan Stojanovič, Ibrahim Selmanaj.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Blerina Pula dhe Nuredin Ibishi

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **06.07.2009**
3. Miratimi i raportit për projektligjin për armët
4. Miratimi i raportit për projektligjin për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike
5. Shqyrtimi i punës së komisionit gjatë sesionit pranveror dhe përgatitjet për sesionin e ardhshëm
6. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje

2. Miratimi i procesverbalit të datës 06.07.2009

Procesverbali i datës 06.07.2009 u miratua pa vërejtje.

Melihate Termkolli – Unë mendoj se në takimin e ardhshëm duhet të ftohet Ministri i FSK-së. Aty ka disa probleme në pranimin e njerëzve në lidhje me kriteret dhe nivelet profesionale. Gjithashtu ka shumë pakënaqësi nga njerëzit e përgatitur dhe profesional. Unë them që në takimin e parë në sesionin e ardhshëm ta kemi një raport nga Ministri i FSK-së.

Kryetari i Komisionit – **tha**, unë në takimin e sesionit të ardhshëm do të ftoj Ministrin e FSK-së, për informatë në lidhje me këtë çështje.

3. Miratimi i raportit për projektligjin për armët

Kryetari i Komisionit – **tha**, ky projektligj ka përfunduar së shqyrtuari në të gjitha komisionet parlamentare, dhe tani keni raportin përfundimtar. Nëse keni diçka, mund të drejtoheni te referuesi z.Shkumbin Demaliaj.

Shkumbin Demaliaj – Pas amendamentit që i kemi bërë në bashkëpunim me UNDP-në, ne si komision dhe grup punues e kemi përfunduar këtë ligj. Pra, në seancën e parë të Kuvendit të sesionit vjeshtor, do të jetë në lexim të dytë.

Emrush Xhemajli – Unë kam vërejtje, nuk mendoj se duhet të mbetet në vullnetin e shoqatës së gjahtarëve, që të përcaktoj se kush është gjuetarë aktiv apo jo aktiv, por mjafton që të kërkohet certifikata e shoqatës së gjahtarëve.

Anëtarët e komisionit miratuan Raportin për projektligjin për armë, me vërejtjet e parashtruara na z.Emrush Xhemajli.

4. Miratimi i raportit për projektligjin për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike

Kryetari i Komisionit – **tha**, edhe ky projektligj ka përfunduar me shqyrtim në të gjitha komisionet parlamentare, dhe tani keni raportin përfundimtar.

Gani Geci – Ky projektligj ka kaluar në të gjitha procedurat. Është shqyrtuar nga të gjitha komisionet dhe nuk ka pas ndonjë vërejtje. Në titullin e projektligjit përveç fjalës

ruajtjen duhet të hiqet edhe shkronja “e” dhe të riformulohet kështu: “ Ligji për rendin dhe qetësinë publike ”.

Eqrem Kryeziu - Unë pajtohem që titujt e ligjeve duhet të jenë sa më të thjeshtë. Dhe po ashtu pajtohem me z.Geci që ky titull i ligjit të riformulohet në mënyrë që të jetë më i çartë.

Anëtarët e komisionit miratuan Raportin për projektligjin për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike me vërejtjet që u paraqiten.

5. Shqyrtimi i punës së komisionit gjatë sesionit pranveror dhe përgatitjet për sesionin e ardhshëm

Kryetari i Komisionit – tha, mbledhjet e mbajtura dhe dëgjimet publike të organizuara nga komisioni kanë shkuar ashtu si duhet. Rasti më i rëndë që ka ndodhur me trajtimin e të cilit është marr komisioni ka qenë vjedhja në dhomën e provave. Një angazhim i pa mjaftueshëm ka qenë nga ana e deputetëve për punëtoritë në të cilat kanë qenë të ftuar. Bashkëpunimi i komisionit me organizatat ndërkombëtare si DCAF-i, UNDP-ja, dhe OSBE-ja, është mjaft i mirë. Në muajin shtator do të organizohet një punëtori për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për policinë.

Shkumbin Demaliaj – Meqenëse po përfundon ky sesion, unë besoj se ne si komision kemi pas parime unike dhe kemi dal të unifikuar për qëndrimet tona. Mirëpo, shprehi keqardhje për mos gatishmërinë e Qeverisë, për përkrahjen e rekomandimeve tona që kanë dal si komision.

Agim Veliu – Unë mendoj se kjo pikë është e zbrazët, për arsye se ne nuk kemi ndonjë raport për punën e komisionit për këtë sesion.

Emrush Xhemajli – Unë them që Ministria e Punëve të Brendshme, është dashur ti merr më seriozisht rekomandimet e Komisionit Evropian, që i ka dërgua për neve. Unë mendoj se ne si Kosovë, mund ta fajësojmë këdo për mos përfshirjen e Kosovës në liberalizimin e vizave, por për këtë jemi fajtor ne vet.

Gani Geci – Në prononcimin për media, Ministria e Punëve të Brendshme thotë se ne kemi pasaporta gjysmë biometrike që nuk përkon me realitetin. Ne do të kërkojmë përgjegjësi nga kjo Ministri për këtë çështje dhe për atë që ka ndodhur në policinë e Kosovës.

Eqrem Kryeziu – Unë do të komplimentoj këtë komision nën udhëheqjen tuaj z.Kryetar, më impresionon përpjekja e këtij komisioni për ti kryer punët si duhet dhe kjo është për ta vlerësuar.

6. Të ndryshme

Meqenëse nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit
Rrustem Mustafa